

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Ekspert Inxhinier Mekanik	Reparti Ushtarak nr.6028, AIM	Tiranë	Pa afat	Po	Po	27.02.2025	13.03.2025
2								

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Ekspert Inxhinier Mekanik
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Drejtoria e Ekspertizës Teknike, në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes.Reparti Ushtarak Nr.6028,
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 27.02.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 13.03.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Ekspert Inxhinier Mekanik.
Arsimi : I lartë universitar “Master Shkencor” ose diplomë e integruar e nivelit të dytë në Inxhinieri Mekanike ose një fushë të ngjashme që ka lidhje me industrinë e mbrojtjes.
- b. Kualifikimi: Në fushën e lartëpërmendur.
- c. Trajnimi: Trajnime në fushën inxhinierike dhe proceseve të prodhimit.
Eksperienca në Punë: Të ketë minimalisht 10 vjet eksperiencë në fushën e inxhinierisë mekanike, veçanërisht në industrinë e mbrojtjes, ose strukturat e Forcave të Armatosura dhe të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe përvojë në: mbikëqyrjen e proceseve të prodhimit dhe testimit të materialeve mekanikë: në projektimin dhe zhvillimin e sistemeve

	mekanikë dhe komponentëve për përdorim në sistemet e mbrojtjes, ose industrinë ushtarake.
d. Gjuha e huaj:	Njohuri të mira të gjuhës Anglisht.
e. Kërkesa të tjera specifike:	Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve kryesore të kompjuterit.
f. Niveli i certifikatës së sigurisë:	sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.

Përshkrimi i punës: Ekspert Inxhinier Mekanik siguron që aktivitetet që lidhen me projektimin, prodhimin, testimin dhe mirëmbajtjen e komponentëve mekanikë për sistemet e mbrojtjes të realizohen në përputhje me standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë. Ky pozicion ka për qëllim përmirësimin e proceseve teknike dhe garantimin e përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare, duke siguruar gjithashtu një mbështetje efektive për zhvillimin dhe modernizimin e kapaciteteve teknike të industrisë së mbrojtjes.

Detyrat kryesore:

- Ofron ekspertizë për projektimin dhe zhvillimin e komponentëve mekanikë, duke siguruar përshtatshmërinë e tyre për përdorim në sistemet e mbrojtjes dhe përmbushjen e kërkesave teknike dhe operationale.
- Siguron që proceset e prodhimit dhe përpunimit të komponentëve mekanikë të përmbushin standardet e ndërveprueshmërisë, sigurisë, cilësisë dhe efikasitetit.
- Merr pjesë në testimin dhe vlerësimin e performancës së komponentëve mekanikë, duke analizuar sjelljen e tyre në kushte ekstreme dhe aplikacione të ndryshme.
- Ofron rekomandime për përmirësimin dhe optimizimin e proceseve mekanikë për të rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të mbrojtjes.
- Siguron mbështetje dhe udhëzime për menaxhimin e mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve mekanikë, duke siguruar që ato të operojnë në kushte optimale gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre.
- Siguron përputhshmërinë e produkteve dhe proceseve mekanikë me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare të ndërveprueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë.
- Pjesëmarrës në zhvillimin dhe implementimin e teknologjive dhe proceseve inovative për përmirësimin e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së proceseve mekanike.
- Harton raporte teknike mbi rezultatet e testimeve dhe rekomandimet për përmirësimin e proceseve dhe procedurave mekanikë.
- Bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet vendase për të përmirësuar praktikatat dhe protokollet e industrisë së mbrojtjes.
- Siguron që protokollet e sigurisë për përdorimin e materialeve dhe proceseve mekanikë janë të përditësuar dhe përmbushin kërkesat ndërkombëtare.
- Monitoron dhe analizon performancën e proceseve mekanikë gjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve, duke siguruar që ato të mbeten efikase dhe të sigurta.
- Identifikon dhe zgjidh problemet teknike që lindin gjatë zhvillimit, prodhimit dhe testimit të komponentëve dhe proceseve mekanikë.

- Ofron trajnime dhe mbështetje për ekipet teknike, duke siguruar që ata të jenë të aftë për të menaxhuar dhe optimizuar proceset mekanikë.
- Vlerëson ndikimin mjedisor të materialeve dhe proceseve mekanikë dhe siguron përputhshmërinë me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit.
- Përgatit dhe përditëson dokumentacionin teknik për proceset dhe procedurat mekanikë, duke siguruar transparencë, konsistencë dhe përmirësim të proceseve të kontrollit të cilësisë për materialet dhe komponentët mekanikë të përdorur në industrinë e mbrojtjes.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimin të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimin të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;

- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperience/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.